

“Dita në të cilën pushteti i dashurisë do ta tejkalojë
dashurinë për pushtet, do të jetë dita
në të cilën bota do të gjejë paqen e vërtetë”.

– MAHATMA GANDHI (1869 – 1945)



Kisha e Jeta

ORGAN I PËRMUAJSHËM INFORMACIONI I METROPOLISË TIRANË-DURRËS Nr. 8 TETOR 2017 Çmimi 30 lekë

ASAMBLE DIOQEZANE
ARKIDIOQEZA METROPOLITANE “TIRANË - DURRËS”



*Sëbashku
drejt
sinodit
dioqezan*



UNGJILLËZIMI
I RI NË
ARQIDIOQEZËN TONË
NJË GËZIM QË RIPËRTËRIHET DHE KOMUNIKOHET

Së bashku drejt Sinodit Dioqezan
Ungjillëzimi i ri në
Arkidioqezën Tiranë-Durrës

Nga Imzot George FREUDO O.P. faqe 3

Sinodi Dioqezan, rrugëtim
për kthim në identitet

Nga Dom Arjan DODAJ faqe 5

Laikët janë urë për në
botën moderne – Papa Pali vi

Nga Elidon DODAJ faqe 6

Thirrja dhe misioni i pazëvendësueshëm i familjes në kishë

Nga Motër Rita DEDA faqe 8

Sinodi Dioqezan, sfidë e
vështirë, por jo e pamundur

Nga Igli GJELISHTI faqe 8

Mbi mondanitetin
shpirtëror dhe lutjen

Nga Dom Arjan DODAJ faqe 9

“Në Kalvarin e
Ditëve Moderne”

Nga Dr. Majlinda GJONI faqe 10

Kushtimi i kishës
së Shën Alfonsit në Kamëz

Nga P. Laureano Del OTERO faqe 12

Kalendari Liturgjik

Nëntor 2017

Një turmë e panumërueshme
nga të gjitha kombet

Zbulesa e shën Gjonit 7, 1-14

Pas këtyre pashë katër engjëj që qëndronin në këmbë në katër këndet e botës. Ai kishte vulën e Hyjit të gjallë. Atëherë dëgjova numrin e atyre që ishin vulosur, 144. 000 nga të gjitha fiset e bijve të Izraelit ... Pastaj pashë: një shumicë të madhe që askush s'mund e numëronte, prej çdo kombi, çdo fisi, populli dhe gjuhe! Qëndronin në këmbë para fronit dhe para Qengjit të veshur me petka të bardha e me palma në dorë. Ata shpallnin me zë të lartë: »Shpëtimi i përket Hyjit tonë që rri në fron dhe Qengjit!«

Të gjithë engjëjt që ishin në këmbë rreth fronit, rreth udhëheqësve dhe rreth katër Gjallorëve, ranë përmbys dhe adhuruan Hyjin. Thoshin: »Amen! Bekim e lavdi, dije e falënderim, nder, pushtet dhe fuqi Hyjit tonë në shekuj të shekujve! Amen!« Atëherë njëri nga udhëheqësit mori fjalën dhe më pyeti: »Këta që janë të veshur me petka të bardha, kush janë dhe nga kanë ardhur?« Unë u përgjigja: »Imzot, ti e di!« Dhe ai më tha: »Këta janë ata që erdhën nga prova e madhe; i lanë petkat dhe i pastruan në gjakun e Qengjit.



- 1 nëntor - Të Gjithë Shenjtërit
2 nëntor – Përkujtimi i të gjithë besimtarëve të vdekur
3 nëntor – Sh. Martini nga Porres
4 nëntor – Sh. Karl Borromeu
5 nëntor – E DIELA XXXI GJATË VITIT
Lum Vinçenc Prenushi e shokët
9 nëntor – Përkushtimi i Bazilikës së Lateranit
11 nëntor – Sh. Martini nga Toursi
12 nëntor - E DIELA XXXII GJATË VITIT Sh. Jozafati
15 nëntor – Sh. Alberti i madh
16 nëntor – Sh. Margarita e Skocisë e Sh. Gertruda
17. nëntor - Sh. Elizabeta e Hungarisë
18 nëntor – Kushtimi i Bazilikave të Sh. Pjetrit e Sh. Palit
1 nëntor - E DIELA XXXIII GJATË VITIT
21 nëntor – Kushtimi i Sh. Marisë Virgjër
22 nëntor – Sh. Çeçilja
23 nëntor – Sh. Klementi I; Sh. Kolumbani
24 nëntor – Sh. Andrea Dûng-Lac e shokët
25 nëntor – Sh. Katerina e Aleksandrisë
26 nëntor – KRISHTI MBRET I GJITHËSISË
27 nëntor – Sh. Valeriani
30 nëntor – Sh. Andrea



Drejtor i përgjithshëm:

Imzot George Freudo

Kryeredaktor:

D. Marjan Lumçi

Sekretar:

Ferdinand Ndocaj

Redaksia:

Kolec Çefa
Ana Stakaj
Zef Skanjeti
Elidon Dodaj

Grafika:

Pjerin Sheldija

Foto: Pici

Adresa:

Katedralja e Shën Palit,
Bulevardi Zhan D'Ark,
Tiranë, Shqipëri

E-mail: kisha.jeta@gmail.com

www.kishadhejeta.com

Së bashku drejt Sinodit Dioqezan Ungjillëzimi i ri në Arkidioqezën Tiranë-Durrës

Asambleja Dioqezane në përgatitje për Sinodin Dioqezan – 07/10/2017

Nga Imzot George FRENDO O.P.



Brenda një periudhe 38 vjeçare dy Sinode të Ipeshkvijve kanë diskutuar Ungjillëzimin – që tregon rëndësinë e temës së Ungjillëzimit për Kishën: në vitin 1974, me temë “Ungjillëzimi në Botën e Sotme”, dhe në vitin 2012, me temë “Ungjillëzimi i Ri”. Pas këtyre Sinodeve, Papa Pali VI botoi Nxitjen Apostolike *Evangelii Nuntiandi* (EN) dhe Papa Françesku botoi Nxitjen Apostolike *Evangelii Gaudium* (EG).

ÇFARË ËSHTË UNGJILLËZIMI?

Fjala *euangelion* (ungjilli) do të thotë “lajm i mirë”. Si lajm, duhet të shpallet. Prandaj fjala “ungjillëzim” do të thotë shpallja e këtij lajmi të mirë të Jezu Krishtit. Pali VI pohon qartë se qëllimi i ungjillëzimit është kthimi, dhe thekson se “nuk mund të ketë njerëzim të ri, nëse më parë nuk ka njerëz të rinj, prej risisë së pagëzimit dhe të jetës sipas ungjillit” (EN 18).

Ndoshta sfida më e madhe për Kishën sot është sfida për të edukuar në fe. Kuptohet, pra, pse Papa Gjon Pali II vazhdimisht theksonte nevojën për “ungjillëzimin e ri”, dhe Papa Benedikti vendosi që Sinodi i vitit 2012 të diskutonte Ungjillëzimin e Ri. Pasi në shkurt 2013 Papa Benedikti dha dorëheqjen, i takoi Papa Françeskut të botonte Nxitjen pas-sinodalen, *Evangelii Gaudium - Gëzimi i Ungjillit*. Vetë titulli tregon çfarë kupton Papa Françesku kur flet për “Ungjillëzimin e ri”. Sepse Ungjillëzimi është shpallja e një lajmi të mirë e të gëzueshëm.

Pra thotë: “Mos të lejojmë vetveten të privohemi nga gëzimi i ungjillëzimit” (EG 83); dhe prapë: “Sa do të doja të gjeja fjalët e dhura për të nxitur një fushatë ungjillëzimi më të zellshme, më të gëzueshme, bujare, të guximshme dhe plot dashuri të pakufijshme dhe joshje të parezistueshme!” (261).

Misioni edukues i Kishës duhet ta çojë njeriun që të dalë nga ajo formë krishtërimi e fosilizuar që e ka reduktuar Krishtin si një hero që përkujtohet me statujat dhe me ritet, dhe të kalojë në atë krishterim që me fe i thotë “po” lajmit të mirë dhe çlirues të Krishtit të gjallë; me atë fe që është e themeluar mbi Fjalën e Hyjit, që na bashkon si familja e Krishtit që është Kisha, dhe që shprehet në kultin komunitar veçanërisht nëpërmjet sakramenteve.

Sot ndihet më shumë nevoja që Kisha të jetë e pranishme dhe aktive në kulturën bashkëkohore. Papa Pali pohon se “ndërprerja e marrëdhënieve mes ungjillit dhe kulturës është pa dyshim tragjedia e epokës sonë”. Dhe shton: “Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet e mundshme për një ungjillëzim bujar të kulturës, ose, më saktë, të kulturave. Ato duhet të ripërtërihen nëpërmjet takimit të tyre me Lajmin e mirë” (n. 20).

Por ungjillëzimi i kulturës nënkupton shumë gjëra. Do të përmend dy kushte kryesore. Së pari, se Kisha duhet të jetë familjare me kulturën e vendit dhe të kohës. Dhe së dyti, se gjuha e ungjillëzimit duhet të jetë e kuptueshme dhe e pranueshme nga kjo kulturë. Dhe këtu duhet të pyesim: Kisha katolike në Shqipëri a është familjare me kulturën vendase bashkëkohore (sepse ka ndryshuar shumë gjatë këtyre njëzet viteve të fundit)? Dhe gjuha e Kishës për të ungjillëzuar a është në sintoni me gjuhën e kulturës së sotme?

Mesazhi qendror i ungjillit është personi i Jezu Krishtit. Por ungjillëzimi nuk përmban vetëm një doktrinë dogmatike. Papa Pali ka folur për aspekte më konkrete në jetën e besimtarëve, pra predikimin e shpresës; predikimin e dashurisë, e cila kërkon prej të krishterëve një farë heroizmi, sepse kjo dashuri ka kurajë të dhurohet, të falë dhe të shërbejë.

UNGJILLËZIMI DHE PROMOVIMI NJERËZOR

Pali VI thotë se “ungjillëzimi nuk do të ishte i plotë nëse nuk do të mbante parasysh thirrjen e ndërsjellë të të vazhdueshme mes Ungjillit dhe jetës konkrete, personale dhe shoqërore të njeriut” (EN 29); dhe “ekzistojnë ndërlydhje të thella mes ungjillëzimit dhe përnxitjes njerëzore” (EN 31). Të njëjtën ide e shpreh Papa Françesku: “Nëse kjo përmasë (shoqërore e ungjillëzimit)

nuk del në pah, ekziston një rrezik serioz i deformimit të kuptimit autentik e integral të misionit të ungjillëzimit” (EG 176). Papa Pali përmend plagët si mungesën e bukës, sëmundjet kronike, analfabetizmin, përnxitjen ideologjike të varfërisë, padrejtësinë etj. (EN 30). Ai paraqet lidhjen mes ungjillëzimit dhe përparimit njerëzor (EN 31).

Çlirimi i vërtetë, thotë Papa Pali, “lidhet me ungjillëzim, i cili synon fitimin e strukturave që sigurojnë mbrojtjen e lirive njerëzore” (EN 39). Por strukturat ungjillore dallohen rrënjësisht nga strukturat e ideologjive politike. Ideologjitë mund t’i ndryshojnë strukturat, por vetëm besimi mund t’i ndryshojë zemrat. Një shoqëri e re, më e denjë për njeriun, nuk sigurohet vetëm me ndryshimin e strukturave, por mund të ndërtohet me ndryshimin e zemrave.

Pas rënies së komunizmit Francis Fukuyama shkroi një ese me titull *The End of History*, ku tha se, me rënien e ideologjive, bota do të gëzojë një periudhë më të qetë. Por më vonë vuri re se kishte gabuar. Pluralizmi nuk solli më shumë tolerancë, por forma të reja intolerance, fundamentalizmi, racizmi. Jo shumë larg nga ne kemi parë lufta të tmerrshme në Ballkan dhe në republikat e ish-Bashkimit Sovjetik. Prandaj pas pak kohe Fukuyama u detyrua të shkruajë një libër tjetër, *Trust*, në të cilin foli për “virtutet shoqërore dhe krijimin e mirëqënies”.

Sigurisht, mjetet e komunikimit janë shumë efektive për të formuar opinionin publik dhe Kisha duhet të bëjë çmos që këto mjete të formojnë një opinion publik të mirë dhe objektiv, dhe të bashkëpunojë me ata që kanë përgjegjësi në këtë fushë, që me sinqeritet dhe mendje të hapur, duke përdorur më shumë këto vegla, të përhapë informacion dhe të pranojë kritikë.

Ndër mjetet për ungjillëzimin Papa Pali dhe Papa Françesku përmendin edhe përshtirërinë popullore. “Ajo shfaq një etje për Hyjin, që vetëm të thjeshtët dhe të varfërit mund ta njohin” (EN 48). S’duhet të harrojmë se kanë qenë praktikë fetare popullore që në këtë vend e kanë ruajtur besimin e katolikëve tanë gjatë regjimit komunist. Detyra jonë është që të edukojmë në fe nëpërmjet besimit popullor.

SHENJA NË PRIRJE

Pas komunizmit në Shqipëri kanë ndodhur ndryshime të mëdha. Përmend disa ndryshime.

Vdekshmëria fëmijërore është zvogëluar, siç është pakësuar edhe numri i lindjeve të fëmijëve në çdo familje. Urbanizimi ka arriur një ritëm shumë të shpejtë. Nëse në vitin 1991 vetëm 35% e popullsisë jetonte në qytet,



sot ka arritur mbi 60%. Shumica e këtyre emigrantëve të brendshëm vijnë nga fshatrat e maleve të Veriut dhe janë katolikë. Ky fakt ka shtuar ndjeshëm numrin e katolikëve në arqidioqezën tonë.

Papunësia është akoma shumë e lartë. Kos-toja e jetesës ka vazhduar të rritet, ndërsa pagat nuk janë rritur në mënyrë të përpjestueshme. Shumë janë pasuruar, disa falë korrupsionit. Por shumica e atyre që njëzet vjet më parë ishin të varfër, sot janë bërë akoma më të varfër.

Pjesëmarrja e popullsisë në zgjedhjet e fundit politike ishte shumë e ulët. Kjo tregon se populli nuk ka shumë besim tek institucionet politike. Në përgjithësi pohojmë se shoqëria sot është më e sigurt. Por kriminaliteti dhe përhapja e drogës janë një problem shumë serioz.

Që nga vitet '90 Shqipëria filloi procesin e privatizimit. Ky proces ka afuar më tepër Shqipërinë me Europën perëndimore, por ka krijuar probleme të reja, mbi të gjitha për më të varfërit. Shumë mjekë dhe mësues kanë kaluar në sektorë privatë, duke lënë një boshllëk në sektorët publikë, i cili është sektori i arritshëm për të gjithë, përfshirë të varfërit.

Sipas studimit të bërë para disa vitësh nga *Caritas Europa*, gati 50% e intelektualëve shqiptarë janë emigrantë; edhe punëtorët më të zotë janë në kërkim të emigrimit. Nëse këto të dhëna janë të vërteta, atëherë kjo është ndoshta forma më e egër e varfërisë së Shqipërisë sot.

Janë verifikuar ndryshime të mëdha: rrugë kryesore të reja, ndërtime të reja, një popullsi më e pasur, supermarkete dhe dyqane ku sot mund të blihet gjithçka, etj.

Ndër ngjarjet kryesore në këtë periudhë përmendim shenjtërimin e Nënë Terezës, që ishte jo thjesht një ngjarje e Kishës katolike, por një ngjarje kombëtare shumë e rëndësishme. Nënë Tereza është simboli i madh dhe bija më e denjë e popullit shqiptar në kohën e fundit.

SHENJA NË KULTURË

Mes jetës në qytet dhe jetës në fshat është krijuar një humnerë e madhe. Në fshatra, familja e vogël (berthamore; *the nuclear family*) ende varet shumë nga familja më e gjërë (*the extended family*); gruaja ende është skllave e një kulture "maskiliste"; traditat janë ende tepër të forta. Në qytet (veçanërisht në Tiranë) të rinjtë janë më

të pavarur nga familja e gjërë dhe nga traditat, ndërsa gruaja është më emancipuar.

Ëndrra kryesore e pjesës më të madhe e të rinjve shqiptarë është emigrimi jashtë vendit. Të vjen keq ta shohësh këtë rini të dëshpëruar. Çfarë shprese mund të ketë për një të ri që dëshiron të ndërtojë të ardhmen e tij? Numri i të papunëve ende është i lartë, pagat janë të ulta: për shumë të rinj nuk ngelet alternativë tjetër përveç emigrimit.

Familja shqiptare, vetë familja më e gjërë, patriarkale, por shumë e bashkuar, nuk i ka rezistuar efekteve shkatërruese të divorcit. Në një artikull të botuar para disa ditësh (në *Shekulli*) lexojmë: "Gjithnjë edhe më shumë martesat po shkojnë drejt divorcit, duke bërë që Shqipëria të hyjë në zonën e kuqe të vendeve që kanë normë të lartë të tyre". Përsa i përket abortit, është i habitshëm numri gjithnjë e në rritje i aborteve. Para disa vitesh, Alma Mile tha se Shqipëria po futet në listën e atyre vendeve ku numri i aborteve është më i madh se i lindjeve. Sot ka shumë nëna që abortojnë edhe kur e dinë se foshnja është vajzë dhe jo djalë.

LEXIMI I SHENJAVE TË KOHËRAVE

Nuk mund të bëjmë një lexim të shenjave të kohërave si të ishim thjesht historianë ose sociologë, por si njerëz të fesë, të bindur që Hyji ynë nuk është Zoti i historisë, që mund të nxjerrë të mirën edhe nga ajo që na duket ose është me të vërtetë e keqe. Në çdo ngjarje duhet të shtrojmë pyetjen: "Çfarë po pret Zoti nga ne në këtë situatë?"

Në një botë anonime, njeriu sot kërkon forma të reja përkatësie. Dean Kelley vuri re se në Amerikë është në rritje numri i atyre që bashkohen me sektet. Pse? Në opinionin tim, arsyeja kryesore është sepse në këto grupe gjenden si në bashkësi. Këtë e shohim edhe në grupe të ndryshme në Kishës Katolike (si Fokolarinët dhe Neokatekumenalët etj). Ne duhet të gjejmë më shumë hapësirë që besimtarët tanë të bashkohen dhe të bashkëpunojnë në grupe të vogla.

Dëgjojmë lajme të këqija të skandaleve të korrupsionit, që shumë herë përfshijnë njerëz në pozicione të larta. Fakti se këto raste bëjnë bujë është shenjë se e keqja nuk ka humbur aftësitë e përplasjes dhe skandalizimit. Kjo tregon se populli nuk është amoral. Është akoma shumë i

ndjeshëm në çështjet e sjelljes etike dhe vlerëson një sjellje shumë të mirë etike.

Kapitalizmi demokratik dhe individualizmi dalin mbi çdo ideologji. Dhe këtë e kemi parë të verifikohet edhe në Shqipëri. Si vendet e tjera ish-komuniste, e para gjë që Shqipëria ka mësuar nga Europa perëndimore ishte pikërisht konsumizmi. Por në këtë situatë Zoti na thërrret, si Kishë institucionale, të tregohemi më të thjeshtë dhe më afër të varfërve (ja pse mora vendim të ndaloj pritjet për politikanët dhe të personalitetëve të tjerë për Krishtlindjet dhe Pashket, dhe i kam zëvendësuar me një drekë për të varfërit).

Gruaja shqiptare nuk është akoma mjaft e prekur nga ai hir çlirimi që Krishti i ka dhënë. Jemi ne, si Kishë Katolike, që mund të dëshmojmë, dhe të ndihmojmë për të komunikuar, çlirim dhe gruas shqiptare. Psikoanalisti Jacques Lacan dhe feministja Simone de Beauvoir thanë se lëvizja për emancipimin e gruas ka filluar në vendet e krishtera. Dhe japin dy arsye për këtë. E para, sepse në konceptin e saj e martesës, Kisha Katolike gjithmonë ka mësuar që kjo lidhje varet nga pelqimi i ndërsjelltë i të dy bashkëshortëve, kështu që njeh dinjitetin e gruas të barabartë me të burrit. Arsyeja e dytë gjendet në thirrjen e motrës. Duke pranuar statusin e motrave, Kisha Katolike ka njohur një dinjitet të vetin të gruas pavarësisht nga martesat.

Edhe një herë dua të përmend figurën e Shën Nënë Terezës. Ajo ka qenë një grua shqiptare, që ka bërë të dëgjohet zëri i saj në favor të të braktisurve. Ajo ka shpallur dinjitetin e njerëzimit pavarësisht nga klasa shoqërore, nga ngjyra e lëkurës e nga besimi. Në një botë konsumiste, ajo, ungjillzuesja e madhe e varfërisë ungjillore, ka tërhequr admirimin e kësaj bote deri në marrjen e çmimit Nobel për paqen. Në jetën e saj dhe doktrinën e saj ka mësuar dinjitetin e gruas, dinjitetin e çdo njeriu si dhe forcën çliruese të varfërisë ungjillore.

PËRFUNDIM

Krezmimi na bëri dëshmitarë të Krishtit. Pra kemi një rol profetik në jetën tonë. Të jemi profetë sot, në Shqipëri. Me guximin e Jeremisë duke lënë "të tërhiqemi" nga Zoti, por duke ndjerë "një zjarr djegës" në zemrën tonë. Me guximin e Izaisë, që tërheq vëmendjen për të varfërit, të vejat, të shtypurit dhe qorton popullin që vazhdon të hajë, të pijë e të argëtohet kinse nuk po ndodh asgjë. Me guximin e Amos-it dhe Ose-së, që sot tërheqin vëmendjen tonë ndaj fëmijëve dhe grave të trafikuar; ndaj njerëzve që kanë nevojë për ndërhyrje kirurgjikale por që nuk kanë mundësi sepse nuk mund t'i paguajnë mjekët; ndaj shumë studentëve që duan të vazhdojnë studimet e larta por nuk mundin sepse nuk kanë asnjë njeri që të ndërhyjë për ta; ndaj shumë familjeve që e kalojnë ditën duke ngrënë një copë bukë dhe pak fasule.

Të jemi profetë sot, në Shqipëri. Ne katolikët sfidojemi nga shoqëria. Por jemi edhe ne që sfidojmë shoqërinë duke dëshmuar vlerat e Mbretërisë së Qiellit. Ky është misioni ynë: të ndërtojmë një shoqëri mbi këto vlera.

Sinodi Dioqezan, rrugëtim për kthim në identitet

Hapja e Asamblesë Dioqezane në përgatitje të Sinodit në Dioqezën tonë Tiranë - Durrës

Nga Dom Arjan DODAJ

Ditën e parë të javës, kur u mbledhëm të ndajmë Bukën, Pali u predikoi vëllezërve e, pasi mendonte të udhëtojë të nesërmen, e zgjati bisedën deri në mesnatë. Në dhomën e sipërme, ku ishim të bashkuar, kishim shumë llamba. Një djalosh që quhej Eutih, ishte ulur në dritare. Pasi Pali predikoi gjatë, Eutihin e rrejtë gjumi dhe fjeti. Ashtu në gjumë, i iku shtati e ra prej të tretit kat poshtë. E ngritën të vdekur. Pali u ul poshtë, ra mbi të, e mori djaloshin para duarsh e tha: "Mos u shqetësoni! Nuk ka vdekur." Atëherë u ngjiti lart e, pasi e ndau bukën dhe hëngri, vazhdoi të flasë edhe për një kohë të gjatë, deri në agim. Atëherë u nis. Djaloshin e çuan në shtëpi shëndoshë me gëzim të të gjithëve.

Nevoja që na mbledh së bashku në këtë Asamble Dioqezane, është, vetëdija e rrezikut që te mos jete vetëm Eutih ai që përgjumbet, por e gjithë bashkësia e Krishtere! E ne nuk mund të qëndrojmë duke pare të shtangur Eutihin që bie në boshllëk; por duhet të bëjmë si Pali që rend ta përqafojë dhe t'i japë jetë shpirtit të tij. Kështu jemi dhe ne, nevojtarë të zgjohemi nga gjumi, dhe te rigjallërojmë kishën tonë nëpërmjet "**ecjes së bashku**" - SINODO

Kisha merr jetë falë dy "lëvizjeve" thellësisht shpirtërore e të lidhura mes tyre.

A) **Nëse kthehet të burimi i Shkrimit Shenjt**

B) **Nëse lejon të provokohet nga mish i njerëzve** që është e thirrur të shërbejë. Pasi ajo vete është e brumosur nga i njëjti mish, prandaj nuk mund të sillet sikur nuk është kështu.

Në episodin e sapo lexuar Pali e ka kuptuar që për të riun Eutih nuk mund të mjaftonte vetëm Shkrimi Shenjt që po predikonte, por është e nevojshme që të zbresë në situatën e jetës së tij.

Po te bllokoni frytshmerinë e vetëm njerës prej këtyre lëvizjeve, do të thoshte që do të realizonim një reformë gjysmake të jetës së Kishës. Sigurisht kemi nevojë që te vihemi në dëgjim të Fjalës, që na është dhënë nga Shkrimi Shenjt dhe tradita e Kishës, por duhet të **dëgjojmë në të njëjtën kohë zërin e shpirtit që flet në zemrën e njerëzve dhe në historinë njerëzore sot**, duke ecur bashkërisht në një dallim të urtë të shenjave të kohës. Kjo do të ishte një aventurë magjepsëse për Arkidioqezën tonë.

Atëherë vjen spontane pyetja: Çfarë na e pengon këtë aventurë?

Papa Françesku na ndriçon që të kuptojmë se me të vërtetë janë **sëmundjet tona shpirtërore** ato që e ndalojnë qarkullimin e jetës së Shpirtit, që i pengojnë bashkësive të krishtera të takojnë në mënyrë më të frytshme të rinjtë dhe familjet e tyre, burrat dhe gratë e kohës sonë. Këto sëmundje na shtyjnë që të kemi vështrimin e shkurtër të kujt nuk percepton drejtimin e duhur të ecjes, dhe që mjaftohet me thënie "unë këtë di të bëj, e jam i sigurtë", kur me të vërtetë, "e sigurtë nuk është".

Në këtë pikë, çdo bashkësi famullitare, realitet kishtar, është mirë që të reflektojë me sinqeritet



mbi cilën është semundja e saj shpirtërore. Edhe me rastin e kësaj asambleje komunitare dioqezane, të pyesim veten:

1- Në çfarë jemi të sëmurë? 2- Çfarë na frenon në dinamizmin e ungjillëzimit. 3- Çfarë na pengon të jemi një nënë me zemër të hapur, të aftë të presim bijë të rinjë e në të njëjtën kohë të dalim të ungjillëzojmë. 4- Pse të rinjtë dhe të rriturit që kemi shoqëruar në fillimtarinë e krishterë, marrin distancë nga bashkësitë tona (sigurisht, për sa varet nga ne). Mund të na ndihmojë në këtë, kapitulli i dytë i EG, 'Tundime të veprimtarëve baritore' (EG 76-101). Do na ofrojë material bazë për të reflektuar.

Duhet të kemi kujdes, **dallimi i sëmundjeve shpirtërore të bashkësive tona** nuk është një veprimtari e thjeshtë! Nuk duhet të bëhet me shpejtësi. Nëpërmjet kësaj bashkësie, ne futemi në një ecje përgatitore për Sinodin, që kërkon liri të thellë të brendshme dhe një dituri të mprehtë të ndriçuar nga Shpirti.

Jemi te thirrur te jetojmë në shpirt urtësie dhe bashkësie, sepse komuniteti nuk ndërtohet vetëm mbi efciencën e një makine organizative, nuk reduktohet në një hapësirë agregative për fëmijë dhe për të moshuar, mbi të gjitha nuk mjaftohet me logjika mondane të llojeve të ndryshme: vet-ecelëbrim narcisist ose triumfalist, besnikëria sterile dhe ideologjike e riteve, zakoneve, mbrojtja e një hapësire të ruajtur dhe siguruese për vetveten, i mbrojtur nga problemet e botës... Kjo nuk është patjetër Kisha e Jezu Krishtit Zot, përkundrazi, ta themi me fjalorin e Papa Françeskut: **I) Mjaft pelagianizmit! Kjo do te thotë: mjaft ecjeve komunitare në të cilat pretendojmë se ndërtojmë Kishën të vetem sipas logjikave krejtësisht njerëzore.** Kisha bëhet një grua shterpe kur humb vështrimin e saj soditës dhe pushon se kryeri një lexim realisht shpirtëror të fesë, mbi çka ajo vete jeton, e mbi çka jetojnë njerëzit e kohës se saj. Duhet t'i besojmë logjikës së lumturive: sa më shumë një komunitet i krishterë bëhet i vogël, i varfër, i butë, sa më shumë përqendrohet mbi marrëdhëniet (si në familje) dhe

jo në strukturat, aq më shumë bëhet e besueshme dhe lejon që ta depërtojë drita e Shpirtit, dhe ne kemi këtë hir në Arkidioqezën tonë, për këtë, të mos lejojmë të mashtrohemi nga stereotipe që vijnë të propozuar nga struktura pa shpirt që pengojnë "sfidën e madhe që kemi përpara në Mijëvjeçarin e Tretë: ta bëjmë Kishën shtëpinë dhe shkollën e Bashkësisë" (NMI 43).

Një komunitet që nuk konvertohet vazhdimisht ndaj Zotit, duke u rinuar si nxënës, është një komunitet që nuk shkon shumë larg: përkundrazi, anetaret e tij do te shperngulen sepse secili do t'i ngjitet rolit dhe ideve të tij. Qe nga fillimi, duke u nisur nga fillimtaria e krishtere e femijëve dhe te rinjve, pastaj ne eksperiencen e katekizimit për te rriturit dhe deri te grupet e te rriturve, duhet te bëjmë që Ungjilli i Jezusit duhet të jetë zemra e çdo ecjeje te Krishtere, me mënyrat e përshtatura ndaj Moshës. Kjo vlen akoma më shumë për adoleshentët dhe të rinjtë: nuk duhet të presim që ata të kenë një moshë ndryshe për t'u treguar atyre fjalën e Hyjit, por është e nevojshme që të bashkojmë Ungjillin me jetën e tyre.

Komunitetet tona janë të ftuara pra të zbulojnë "Kënaqësinë që të jenë popull" (EG 268-274). Për këtë, instistimi i Papës është këtu shumë i shëndetshëm, na bën mirë, sepse na kujton që ne Krishtin jemi të lidhur njeri ndaj tjetrit, e nëse ndahemi, kush paguan, jemi të gjithë. Te ndahemi nga të tjerët qofshin ata vëllezër të komunitetit të krishtere, apo banorë të së njëjtës lagje, do të na sëmundte.

Është nga **soditja e mishërimit** që mësojmë të bëjmë tonen një stil ndryshe, atë me të cilin Jezusi iu afrohej njerëzve duke bashkëndarë jetën me simpati autentike, dhe duke hyrë në relatë të thellë, duke u bërë barrë e dhimbjeve dhe lodhjeve të të tjerëve. Është kjo që Papa thërret, 'revolucionin e butësisë': një mënyrë plotësisht ungjillore për të jetuar marrëdhëniet. **II) Pra mjaft individualizëm dhe afirmim i një identiteti privatist.** Për këtë, vështirësitë që mund të hasen edhe duke punuar bashkë, tregojnë jo shumë paaftësinë organizuese apo mungesën

e kohës, por ndoshta një të përhapur **sëmundje shpirtërore të individualizmit, autereferencimit, sikur të ecnim përpara në dy binarë të ndryshëm me jetën e Krishtit të mishëruar.**

Nganjëherë, besojmë se e shohim botën nga ballkoni i sigurive tonal. Por me kohën, siguritë zbehen dhe përfundojmë për të thënë ose bërë gjërat e përhershme, që mund të jenë: katekizmi i fëmijëve, ose të rriturve, ndoshta shumë sakramente të dhëna atyre që nuk kanë as përgatitjen me minimale për t'i marrë, pra pa ndërjegjjen e përshtatshme; ndonjë praktikë devocionale, por që rrezikojnë të mos ndërveprojnë me njerëzit që na rrethojnë. **Duke bërë kështu, mungojmë në Fe në Pashkët e Zotit të Ringjallur, që vepron edhe sot nëpërmjet Shpirtit, në botë e në zemrat e njerëzve. III) Mjaft pesimizëm shterp.** Nuk është e mundur për komunitetin e Krishterë të harrojë historinë e njerëzve. Të ndalemi së kërkuari njerëzit, së hyri në gëzimet dhe në shpresat e tyre, trishtimet dhe ankthet është një formë ateizmi praktik. Nxënësi i Jezusit që do të shihte në njerëzit dhe në botë vetëm një vend pagan, pa prezencën e Hyjit, plot errësirë e armiq, është një nxënës që nuk beson në Pashkët që veprojnë në histori.

Me të rinjtë, duhet të bëjmë një baritore 'shqiptarce', që do të thotë se jemi të thirrur t'i takojmë; kush me shumë se shqiptaret ka në zemër kulturën e takimit dhe të mikpritjes. T'iu kthejmë të rinjve tanë eksperiencën e popullit tonë, të mos flasim mbi ta, por të flasim me ta. Atëherë do të rinjohim fytyrën e bukur e të brishtë, shpesh tepër të brishtë, të prishur në njëmijë mënyra nga vetmia, nga varësitë, nga arroganca dhe

dhuna e kujt i përdor dhe abuzon me ta.

Kur janë midis tyre ndoshta na duken një kope e rrezikshme, e padepërtueshme, por e dimë që është vetëm një fasadë, manifestimi i një dobësie të thellë. **Zoti do që t'i takojmë.**

Duhet të jetojmë kontaktin që mund të realizohet me adoleshentët, veçanërisht nëpërmjet botës së shkollës dhe ose të momenteve të jetuara në eksperiencat e famullisë ose grupeve të ndryshme. Është e frikshme situata e daljes nga rruga që jetojnë shumë adoleshentë, nganjëherë në heshtjen e zhurmshme të të rriturve dhe të institucioneve dhe shpeshherë ndoshta edhe tonën. **Të rinjtë tanë dhe adoleshentët, jetojnë në kohën tonë, një eksperiencë të thellë si jetimë shpirtërore.**

Kjo punë është e çmuar edhe për ne, si komunitet i krishterë na shtyn që të rinohejmë dhe të pranojmë sfidën për të jetuar transformimin e nevojshëm për ungjillëzimin e brezit të vjen. Fillojmë e kuptojmë atëherë që subjekti që është thirrur të konvertohet e të pranojë si nënë të rinjtë e familjet e tyre, **është i gjithë komuniteti i krishterë.** Sa është e nevojshme që të jemi plotësisht të bindur për këtë, e të vetëkuptojmë deri në fund pasojat e saj. Zakonisht mendojmë që ungjillëzimi i të rinjve kërkon teknika të veçanta afrimiteti, oferta formative të sofistikuar, edukatore profesionale (ose fishekzjarre baritore), pa të cilët asgjë nuk do të ishte efektive: e pasi nuk janë në lartësinë tonë, shkuraohemi që në fillim. Kush njihet e iu afrohet adoleshentëve, e dinë që kanë nevojë themelisht për të rritur si pikë referimi për ta, për komunitete të cilave t'iu përkasin dhe që shprehin ndaj tyre një sensibilitet dhe një kujdes

atnor e amësor, pa qenë patriarkale. Ndjehen mirë nëse jetojnë lidhje që t'i bëjnë të ndjehen në shtëpi; të lirë, sepse janë në kërkim të një identiteti të tyre, por në shtëpi.

Që ky proces i të shndërruarit në të krishterë të funksionojë, kërkohet kujdesi i të gjithë komunitetit të krishterë, një shoqëri e besueshme për të cilën fliste Papa Benedikti. Duhet "vetëm" (mes thonjzash) të konvertohem drejt një sjelljeje me një kujdes dhe hapje. Edhe gjuha e përshtatshme me të rinjtë nuk buron nga takime të bëra në tavolinë midis edukatoreve, por nga një komunitet i apasionuar ndaj Ungjillit dhe ndaj të rinjve. Ky komunitet duhet të dijë të gjejë fjalët për t'u kuptuar.

Kisha është një familje: figura është ajo e sofrës shtëpiake, në të cilën Zoti na fton të gjithëve për t'u ulur, një sofër ku ka vend për të gjithë, që secili të ndjehet në shtëpi. Kjo shtëpi është shtëpia e Trinisë: Hyji ka përgatitur në vetvete një vend për secilin prej nesh. Është shtëpia ku perceptohet prezenca e Asaj që është Nënë, dhe ka kujdes që në zemrat e bijve të mos mungojë vera e gëzimit dhe e shpresës. Këtu mbi tokë është kisha sakramenti i dashurisë amësore të Hyjit që na fton të gjithëve në sofrën e Mbretërisë së Hyjit, në sofrën e Fjalës dhe të Eukaristisë: mëkatore, të varfër, topallë, të verbër, të vjetër e të rinj. Të gjithë, të rinj e të rritur janë në zemrën e Hyjit. Nëse është kështu, neve na kërkohet vetëm të vihemi në shërbim të Zotit që i kërkon, i thërrret, i fton të ulen në sofrën e Fjalës dhe të Eukaristisë, i bën që të ndjehen në shtëpi. Kur mendojmë për ta, duhet të imagjinojmë në këtë "vend": në zemrën e Hyjit. Është aty që duhet të jetojmë e të kërkojmë thirrjen e të gjithë neve.

Laikët janë urë për në botën moderne – Papa Pali VI mbi apostullimin e laikëve

Nga Elidon DODAJ

Shumë i nderuar Arqipeshkvi ynë Metropolit i Tiranë – Durrësit, Imzot George Frendo O.P. të nderuar meshtar, rregulltar e rregulltare, laik të kushtuar, shumë të dashur vëllezër e motra në të njëjtin pagëzim në Krishtin e Ngjallur.

Nuk e kam aspak të lehtë të flas sot para një numri kaq të madh të pranishëmve për një nga temat më të thekura le të them pikante të këtij fillim mijëvjeçari. E të flasësh pikërisht për Apostullimin e Laikëve përpos që duhet një bagazh tepër i madh, por edhe një shpirt i lirë komunikimi mes asaj çfarë mësuesit e Kishës na kanë lënë sot e kësaj dite nëpërmjet koncilëve, dekretëve, dokumenteve, letrave, etj. Në dekretin Apostolicam Actuositatem (Veprimtaria Apostolike) thuhet: **“apostullimi i laikëve ... rrjedh prej vetë thirrjes së tyre të krishterë, - e ky apostullim, nuk mund ti mungojë asnjëherë Kishës. ... kohët tona nuk kërkojnë një zell më të vogël nga ana e laikëve; madje rrethanat e sotme kërkojnë absolutisht që apostullimi i tyre të jetë më intensive dhe më i zgjeruar.”**¹



Në këtë mijëvjeçar të ri ku shkenca përparon dhe teknologjitë po arrijnë të bëhen gjithnjë e më shumë interaktive - apostullimi i laikëve ka zënë vend kudo, por janë bërë edhe shkaktar të problematikave të reja, që kërkojnë angazhim dhe gatishmëri të shpejtë. Ndaj nevojitet një thirrje pse jo urgjente e laikëve për apostullim. Shoh sot këtu

të pranishëm, që shumë nga ne jemi pjesë aktive e Kishës, por mos harroni në laikët në botë, por edhe këtu në Dioqezën tonë zëmë pothuaj 99% të Kishës. Apostolicam Actuositatem (Veprimtaria Apostolike) përfundimisht thotë se laikët duhet të luajnë një rol më aktiv në Kishë dhe veçanërisht në botë. Ne laikët duhet të kemi një përgjegjësi jashtëzakonisht të rëndësishme për të zbuluar atë që do të thotë të jesh i krishterë para botës. Siç

¹ Dokumente të Koncilit II Ekumenik të Vatikanit, "Dekreti mbi Apostullimin e Laikëve", Botime të

na porositi Papa Pali i VI - pesë dekada më parë **“Laikët janë urë për në botën moderne”**.

Veprimtaria Apostolike përfundimisht thotë – po e theksoj dhe do ta përsëris shpesh gjatë kësaj fjale: se ne laikët duhet të luajnë një rol më aktiv në Kishë dhe veçanërisht në botë (konkretisht këtu në dioqezën tonë). Ndaj na duhet për ta kuptuar më mirë dokumentet që dolën nga Koncili i Dytë i Vatikanit. Merrni një moment dhe mendoni vetëm për ndarjen që ndodh midis botës dhe botës që përcjell mesazhi i Ungjillit. Ne laikët kemi një përgjegjësi jashtëzakonisht të rëndësishme për të zbuluar atë, e që do të thotë të jesh i krishterë.

Një i krishterë ka vetëm një qëllim të vërtetë si apostulli i Krishtit - që të përhapë Fjalën e Krishtit, Ungjillin. Ne duhet të ndajmë dashurinë e Krishtit në mënyrë që të tjerët të marrin pjesë në shpëtimin e Tij duke hyrë në marrëdhënie me Zotin. Secili prej nesh ka një rol për të luajtur. Pjesëmarrja në këtë rol është thelbësore dhe e dobishme për ne individualisht dhe për të gjithë Kishën. Ne laikët e marrim këtë detyrë direkt nga vetë Krishti, përmes sakramenteve duke marrë kështu Shpirtin Shenjtë. Shpirti Shenjt na jep dhurata specifike e të nevojshme që ne të mund të kontribuojmë. Nga dashuria bashkëpunojmë dhe i nënshtrohemi vullnetit të Zotit. Sot një laik duhet të jetojë jetën në Krishtin përmes kulturës dhe shoqërisë. Këto të dyja nuk janë të ndara. Nëse jeta në të cilën jetojmë nuk na drejton drejt besimit, shpresës dhe dashurisë, do të bënim mirë të ndryshonim se si jetojmë. Të jetojmë në besim nënkupton se duhet të përqijemi ta shohim Krishtin tek të gjithë. Kjo fillon duke vlerësuar të gjithë jetën. Të shpresojmë është të shohim se vuajtjet njerëzore mund të ndryshohen. Shpresa është për të dhuruar dashuri duke gjetur kuptim në përpjekjet e jetës. Ne shpresojmë për dashuri, sepse kulmi i jetës së krishterë është dashuria. Dashuria është themelore që në fund të fundit të zgjedhësh të mirë për të keqen. Të jesh në gjendje të duash në nivelin më të thellë, kërkon dorëzimin. Nuk ka dashuri më të thellë pa përlësi. Vetëm duke fituar përlësinë, fillojmë të njohim vetveten në të vërtetë. Duke e kuptuar veten, fillojmë të dallojmë se mirënjohja është për shkak të gjithçka që ne marrim. Kur një person e kupton ato çfarë vijnë nga Hyji, pjekemi për drejtësi.

Qëllimi ynë është të komunikojmë hirin e Hyjit në botë, duke zbuluar Jezusin dhe fjalët e tij. E gjitha kjo është projektuar nga Krishti që fillon me Liturgjinë. Kështu që duhet ta theksojmë vetëm përmes Liturgjisë. Jemi dërguar për të dhënë dëshmi nga jeta jonë. Kjo dëshmi ka për qëllim të ftojë të tjerët të marrin pjesë në jetën e Krishtit në Kishën e tij. Misioni ynë përfshin edhe aspekte të tjera të jetës sonë, si familja, miqtë, kultura, artet, puna, politika dhe realitetet ndërkombehtarë. Në shumë mënyra, bota është verbuar nga mëkati dhe si rezultat njerëzit janë bërë egoistë dhe e shohin jetën vetëm në një mënyrë - mënyrën e tyre. Kisha ka për detyrë të ofrojë qartësi (mbështetje) morale dhe të sigurojë ndihmë shpirtërore. Megjithatë, edhe ne anëtarët e Kishës që përbëjmë shumicën mund ta kemi si qëllim tua japim qartësinë (mbështetje) morale dhe ndihmën shpirtërore atyre që do na e kërkojnë. Tek e fundi mesazhi i secilit prej nesh

është të përcjellim dashurinë. Çdo gjë që bëjmë si të krishterë duhet të motivohet nga dashuria. Shkalla më e lartë e dashurisë përfshin dhembshuri për ata që janë në nevojë. Maja e dashurisë është dorëzimi i vetvetes, për të siguruar atë që është një e mirë më e mirë.

Dinjiteti i njerëzve kërkon që ata të kenë ushqim, pije, veshje, strehim, mjekim, qasje në punë, arsim dhe liri veprimi. Është detyra jonë të japim mbështetje dhe mundësi në mënyra se si ne mundemi. Pavarësisht se cila është ndalesa e një personi në jetë, ne duhet t'i duan të gjithë në mënyrë të barabartë siç na do Zoti. Asnjëri prej nesh nuk është më i mirë se tjetri. Nocioni më i drejt i dashurisë është të kërkojmë atë që është e drejtë. Kështu që lind nevoja që të lehtësojmë nevojat e vëllezërve nëpërmjet bamirësisë. Duke eliminuar shkaqet e padrejtësisë, në bashkëpunojmë me dashurinë e Hyjit. Bamirësia jonë duhet të vijë nga zemra nga ajo pjesë që është me e nevojshmeja e jona duke hequr dorë prej saj. Vetëm kështu kemi vënë në veprim bamirësinë. Nuk kërkohet të bëjmë gjëra të mëdha, por siç na porosit Shenjta Tereza e Kalkutës – mjafton që të bëni gjëra të vogla, por me dashuri të madhe.

Secili prej nesh thirret në forma të ndryshme për të dhënë njëfarë shërbimi. E vërteta e një shërbimi për të gjithë të krishterët bëhet e qartë nga mënyra se si ata shprehin besim në çdo veprim të ditës së tyre. Grupet që ofrojnë dashuri e bamirësi për fqinjën japin dëshmi të fuqishme për Trupin e Krishtit. Mjafton edhe qëndrim pranë njëri-tjetrit që ne me besim të jemi të fortë. Jeta e përditshme me Shpirtin e Krishtit është qëllim ynë.

Të gjitha përpjekjet individuale ose të organizuara duhet të funksionojnë në raport me hierarkinë e Kishës. Ajo duhet të forcojë bashkimin tonë me të. Hierarkia duhet të promovojë punën e laikëve dhe të japë frymën drejtim. Veprimtaritë baritore duhet të nxisin edhe laikët në përfshirjen e tyre, qofshin këto mësimi i fesë (katekizmi), përgatitja e Liturgjisë, mos të ngelet thjesht punë e meshtarëve dhe motrave. Ipeshkvi dhe meshtarët kanë për qëllim të punojnë ngushtë me laikët në ndërtimin e Kishës së gjallë.

Secili prej nesh është i thirrur në shërbimin për të vënë në përdorim talentet tona. Ndaj formimi i secilit është një e mirë e komuniteteve tona. Apostullimi na takon të gjithëve. Me fjalë të tjera, të gjithë jemi apostuj me një "a" të vogël. Asnjëri nga ne nuk mund të jetë vërtet një i krishterë pa qenë gjithashtu edhe apostull. Një apostull duhet të jetojë dhe të shpallë Krishtin. Megjithatë, sfida për shumë nga ne laikët qëndron në faktin se si ata ndjehen dhe ndajnë besimin e tyre nga jeta e përditshme.

Le të ndalemi dhe të mendojmë për diçka. Thuhet se ne duhet të kërkojmë vullnetin e Zotit. Nëse është kështu e vërtetë, atëherë është e arsyeshme të supozojmë se ne duhet të jemi të hapur për të vërtetën e atij vullneti. E gjithmonë ka një formë thirrje nga Zoti, nëpërmjet Krishtit, që nxitet nga Shpirti Shenjtë. Është vullneti ynë i lirë që na lejon të jemi të hapur ose të mbyllur për këtë thirrje. Mund të zgjedhim të përgjigjemi ose jo, të tërhiqemi thjesht në një marrëdhënie dashurie me Zotin ose të largohen prej tij. Kisha dhe laikët përbëjnë të tërën e vetëm kështu ajo

kryen shërbesën e saj dhe vihet në shërbim të gjithë komunitetit.

Shën Gjoni XXIII thirri Koncilin e Dytë të Vatikanit duke ua besuar laikëve rolin e rëndësishëm të shqyrtimit të diskutimeve – e ky Koncil u quaj Koncili i laikëve. Sepse laikët formojnë pjesën e madhe të Kishës, siç e thashë më herët ata përbëjnë 99% të saj! Ndoshta këtë po kërkon edhe Ipeshkvi ynë sot, po na fton që të gjithëve në këtë Sinod Dioqezan. Sot punoj si një punonjës i një prej enteve të kishës krah për krah me shumë prej jush që e duam Krishtin dhe përqijemi t'i shërbejnë atij. Pa mbështetjen e shumë prej jush, punët do të ngelnin në vend numëro. Ndaj shpesh kërkojmë edhe lutjet tuaja, sidomos nga grupet e lutjeve nëpër bashkësitë tona famullitare, rregulltarë, që secilit ent i kishës - Zoti t'i jap hirin, që punonjësit e tyre të jenë shembull drejtësie. Përgjegjësia më e madhe për ne laikët nuk qëndron në kryerjen e shërbesave në Kishë. Ndikimi më i madh i yni është kur të dërgojmë në botë (familje, lagje, punë, shoqëri, etj) pas çdo meshe të së dielës mesazhin e Krishtit të Ngjallur. Më shumë se kurrë ne laikë pse jo besnik katolik jemi të nevojshëm në botë. **Pse?** - Të luftojmë indiferencën në rritje ndaj fesë. Mjerisht, Koncili i Dytë i Vatikanit nuk është përqafuar me të vërtetë nga shumë prej nesh. Bota është shumë me shumë laike, materialiste dhe konsumiste. Njerëzit sot vlerësojnë vetëm atë që është fituar materialisht – tek e fundit a kam një rrogë në fund të ditës dhe i gëzohen asaj. Askush nuk është i shqetësuar për pjesën tjetër që ndoshta po kalojnë kriza të pa perceptueshme. Dhe me të gjitha përparimet e mëdha në teknologji, ekziston një e vërtetë e trishtueshme madje themelore: teknologjia tani kontrollon njeriun më shumë sesa njeriu kontrollon atë.

Duhet dhe mundet: sepse ka më shumë të pagëzuar laikë aktivë në shërbim në Kishë se kurrë më parë, por ka më shumë ish-besimtarë se kurrë më parë. Duhet të mendojmë për këtë dhe le të marrim një vendim për veten tonë. Shumica e njerëzve që njohim nuk do ta dëgjojnë Ungjillin në kishë. Nëse ata kanë ndonjë shpresë që ta dëgjojnë, do të jemi ne. Ta mbajmë mend gjithashtu - nuk mund ti jepni dikujt tjetër atë që nuk e ken! Papa Françesku thotë : **“... nuk ekziston jetë e krishterë e përcaktuar në tryezë, e ndërtuar shkencërisht, ku mjafton të zbatosh disa rregulla për ta qetësuar ndërgjegjen. Jeta e krishterë është udhë e përvuajtur e ndërgjegjes, që nuk duhet të ngurtësohet kurrë e duhet të mbetet gjithnjë në marrëdhënie me Zotin. Ndërgjegje, që di të pendohet e t'ia besojë veten Hyjit, pa menduar se i mjafton vetvetja. Vetëm kështu kapërcehen hipokrizia, dyfytirësia, klerikalizmi, legalizmi, shkëputja nga njerëzit. Zoti kërkon njerëz të pastër në zemër, jo të pastër nga jashtë, si mëkatarët hipokritë.”**²

A jemi ne gati të bëhemi një urë që sjellim katolicizmin në dioqezë?

***Drejtor i Caritas Dioqezan Tiranë – Durrës
PhD Cand. Shkenca Komunikimi-Gazetari**

² http://sq.radiovaticana.va/news/2017/10/02/papa_në_bolonjë_kisha,_familja,_shoqëria,_takimi/1340308

Thirrja dhe misioni i pazëvendësueshëm i familjes në kishë

Nga Motër Rita DEDA



Zemra e këtij Sinodi Dioqezan dëshiron të jetë Shpallja e Ungjillit, *Lajmi i Mirë* në një kohë të re (në të sotmen e historisë e cila na kërkon të lexojmë “shenjat e kohës” përballë sfidave baritore, ndryshimeve të të menduarit, vepruarit, zgjedhurit, vlersuarit, komunikuarit etj); por është edhe një kohë e volitshme, kohë hiri, dashurie, falje dhe kthimi, ku Zoti vetë takohet me njeriun dhe e përtërin.

Para së gjithash duhet të themi se “*Kisha si nënë me zemër të hapur egziston për të ungjillëzua*”: d.m.th predikim dhe mësim, – kanal hiri dhe pajtimi, – kremtimi dhe falënderimi. Papa Françesku duke iu referuar *Evangelii Nuntiandi* 14. thotë se, “të ungjillëzosh është hir dhe vetë thirrja e Kishës, identiteti i saj thelbësorë”.

Çelsi i kumtimit të Lajmit të Mirë, të “Gëzimit të Ungjillit” është pikërisht **familja**. Nuk mund të harrojmë, as të nënvlerësojmë se një pjesë e mirë e “ungjillëzimit të ri” varet nga “Kisha Shtëpiake” dhe të vepruarit e saj, qoftë brenda apo jashtë mureve ku ajo shtrihet dhe vepron.

“Kjo do të thotë që në çdo **familje të krishterë**, duhet të pasqyrohen aspekte të ndryshme të Kishës në tërësi. Prandaj familja, sikurse Kisha, duhet të jetë një hapsirë në të cilën Ungjilli Shpallet dhe nga ku Ungjilli transmetohet”.

Këtu del në dritë edhe **thirrja** e familjes dhe **misioni** i sajë i dyfishtë: pranuese e Lajmit të Mirë dhe ungjillëzuese, vend ku mësohet feja dhe dëshmohet. Vatër ku çdo pjestarë i familjes jo vetëm e merr, por edhe ia shpallë “lajmin e gëzueshëm tjetrit”. Poashtu një familje e ungjillëzuar dhe e vetëdijshme për misionin që i është besuar bëhet ungjillëzuese për shumë e shumë familje të tjera. Në shumë raste dhe situata laikët - familja, arrin aty ku Kisha nëpërmjet klerikëve – të kushtuar nuk mund të arrijë. Ajo luan një rol ndërmjetësues shumë të rëndësishëm, jo vetëm si protagoniste e *ungjillëzimit të ri* por edhe si favorizuese e dialogut mes Kishës dhe shoqërisë.

Me fjalë të Koncilit II, familja është “**objekt dhe subjekt ungjillëzimi**”, me *dëshminë* e jetës së vet, me *fjalë* dhe me *shenja*.

Është detyrë jonë (e Kishes), që të ndihmojmë familjet të kuptojnë pasurinë e dhuratave që kanë marrë dhe çdo ditë marrin prej Shpirtit Shenjt, por edhe rolin e tyre të paçmueshëm dhe të pazëvendësueshëm brenda Kishës – *Familje e familjeve*.

Duhet të inkurajojmë dhe ti nxisim familjet “që të rriten në vetëdijen e një ministerialiteti i cili buron nga sakramenti i martesës dhe thërret burrin dhe gruan të jenë shenjë e dashurisë së Zotit që përkujdeset për çdo bir të vetin”. Nën dritën e *ungjillëzimit të ri*, “Martesa dhe Familja” janë të njohura si një ndër të mirat më të çmueshme të njerëzimit, shenjë dhe imazh i dashurisë së Zotit, bashkëkrijues dhe bashkëveprues të planit Hyjnor. Bashkëshortët - familja e krishterë edhe pse me ato limitet dhe mangësitë e veta paraqitet si një refleks i gjallë, një imazhë i vërtetë i dashurisë së Krishtit për Kishës. Në Eukaristi ata përjetojnë dhurimin më të madh që Hyu u bën, nga edhe zbulojnë identitetin e tyre thelbësorë dhe thirrjen në shërbim të botës. Eukaristia dhe familja manifestojnë të njëjtin mister dashurie, (Kr. Ef. 5).

Për këtë qëllim ajo është e thirrur të jetë komunitet dashurie, feje dhe ungjillëzimi, të ushqyer me Fjalën dhe sakramentet në dialog intim me Zotin vëndosen në shërbim të vëllezërve dhe Kishës. Për këtë qëllim duhet të mendohen forma të ndryshme përfshirjeje të familjeve në jetën e Kishës dhe në baritoren e saj.

Prandaj në këtë kohë përgatitje për hapjen e Sinodit Dioqezan të angazhohemi edhe më shumë që “Lajmi i Mirë” të përçohet tek të gjitha shtresat njerëzore, i cili transformon nga brenda dhe ripërtërin njerëzimin, jo vetëm me fjalë por, sikurse thotë Pali VI edhe duke “shpërbërë nëpërmjet forcës së Ungjillit kriteret e gjykimit, vlerat e përcaktuara, pikat e interesit, rrymat e të menduarit, burimet frymëzuese, që janë në kundërshtim me Fjalën e Zotit dhe planin e shëlbimit”. Nuk mjafton të njohim sfidat baritore që ekzistojnë, shkaqet apo pasojat, por edhe se si ti përballojmë ato.

Pyetja që duhet të bëjmë dhe mbi të cilën duhet të reflektojmë është; cilat janë zgjedhjet dhe qëndrimi ynë korret, ungjillorë pra, përballë sfidave baritore mbi familjen (dhe jo vetëm) që paraqesin sot në vendin tonë në kontekstin e *ungjillëzimit të ri*? Sikurse na mëson Papa Françesku, me optimizëm dhe një shpresë të ripërtërirë, të bindur se do të jetë “freskia e parë e Ungjillit që do të na hapë shtigje të reja, metoda të larmishme, me forma të ndryshme të shprehuri, shenja më shprehëse [...] për botën aktuale”. Kjo përgatitje për sinodin do të na mundësojë që së bashku në dialog, jo vetëm të hetojmë sfidat me të cilat Dioqeza dhe familja sot përballen, por edhe të *gjejnë udhezimet e të vepruarit baritore* të personit dhe të familjes.

Prandaj me një vullnet të mirë e zemër të hapur ta lejojmë Shpirtin Shenjt promovues i çdo misioni në Kishë ti frymëzojë dhe ti udhëheqë mendjet tona gjatë kësaj kohe për të mirën e tërë njerëzimit. Me Papa Françeskun të themi “mos të lejojmë të na e rrëmbejnë shpresën” [...] “dhe forcën misionare”.

Familja e Shenjtë e Nazaretit, model i martesës dhe familjes e shoqëroftë Dioqezën tonë dhe çdonjërin prej nesh në këtë ecje sinodale të *Shpalljes së Ungjillit*.

Sinodi Dioqezan, sfidë e vështirë, por jo e pamundur

Nga Igli GJELISHTI

Inderuar e fort i dashur, Monsinjor George, Kryebariu i Arkidioqezës sonë,
I dashur vikari i përgjithshëm i Arkidioqezës sonë, Don Arjan,

Të dashur Meshtarë e Motra, të dashura motra e vëllezër në Krishtin,

Me pothuaj të gjithë besimtarët e Katedrales, njihemi prej gati dy vjetësh. Për të tjerët, unë jam Igli, e së bashku me Avisin që sot është ime shoqe, të dielën e shkuar përkujtuam me shumë gëzim përvjetorin e dytë të një së enjteje të tetorit të vitit 2015, kur shkua në Katedrale, morëm pjesë në Meshën

e Shenjtë e menjëherë më pas nisëm Katekizmin.

Më kujtohet shumë mire atë ditë Dom Marjani që pasi më pa se largu, m'u afrua e me tha jo pak i habitur: Ah, erdhe përnjimend! Në fakt edhe unë isha disi i habitur me veten, por ajo habi do zhdukej shumë shpejt e do ia linte vendin një farë zemërimi të vogël, po me veten. Një zemërim me faktin që e kisha vonuar aq shumë këtë gjë. Një zemërim për faktin që megjithëse Krishtin e kisha njohur që fëmijë, e kisha besuar te Ai gjithë jetën time prej atëherë, madje s'kam pasur kurrë dyshim për t'u vetëquajtur i krishterë, padija me

kishte mbajtur larg së vërtetës. Them padija, për të mos përdorur termin më të rëndë 'injanca', sepse realisht isha i paditur.

Pagëzimin e kujtoja thjesht një procedurë e asgjë më shumë. Për krezmimin mbase s'kisha dëgjuar ndonjëherë. E sigurisht, nuk kisha as më të voglën njohuri mbi fuqinë e Eukaristisë, mrekuallinë e takimit me Zotin. (Besoj është e kuptueshme që librat me të cilat isha ndeshur fëmijë e nëpërmjet të cilëve kisha njohur Zotin, nuk ishin botime katolike, por edhe aq, e kryen misionin e vet).

Se ç'ndodhi pas asaj të enjteje në jetët tona, e



sidomos disa muaj më vonë, pas pagëzimit, une e kam shumë të vështirë ta shpreh me fjalë, por kam besimin që meqë të gjithë ushqehemi nga i njëjti burim lumturie, e merrni me mend se ç'do doja t'ju tregoja.

Të gjithë këtë hyrje, e bëra sepse jam i sigurt që ashtu si unë, ka jashtë derës së Kishës shumë të tjerë "të paditur". Sepse e di që ashtu si unë, ka shumë që s'kanë lindur në familje katolike, e nuk guxojnë ta kalojnë prapun e Kishës sepse mendojnë se ajo është e hapur vetëm për një komunitet të ngushtë njerëzish që nuk i mirëpresin të tjerët. Atyre do t'ju mjaftonte një takim, një fjalë, një buzëqeshje, për të kuptuar që nuk është kështu, për të zbuluar

të Vërtetën e për të marrë rrugën e duhur. Unë, s'e pata këtë mundësi, e m'u desh të pres 31 vjet për ta kapërcyer atë prag. Ama, unë pata fatin e madh, që pasi e bëra, të takoj njerëzit e duhur, qoftë priftërinj, e qoftë besimtarë të tjerë, që më bënë më të prekshme e më të përjetueshme forcën e dashurisë së Hyjit. Jo të gjithë e kanë këtë fat, e në shohim shumë raste edhe në Kishën tonë që shumë të rinj, pasi vijnë, pasi marrin sakramentet, largohen e nuk i shohim më aty.

Me aq sa kam pasur mundësi të bisedoj këto dy javë, kam vënë re që për këtë Sinod që nisim të përgatisim sot, ka një miksi ndjenjash e mendimesh. Ka që mendojnë se është i nxituar, ka që mendojnë se është i pamundur, ka madje edhe që mendojnë se është i panevojshëm. Sigurisht ka më shumë nga ata që janë entuziastë dhe besimplotë, ndërsa ajo që i bashkon të gjithë, është mungesa e informacionit të plotë mbi çfarë është një sinod. As vetë s'e kam akoma shumë të qartë, por më gëzon tematika e tij.

Personalisht mendoj se që prej kohës kur Shën Pali ka kaluar në këto anë, nuk ka pasur një moment më të mirë që shqiptaret të ungjillëzohen. Pas 5 shekujsh pushtim nga jashtë, e pas 5 dekadash çmenduri të brendshme, sot jetojmë një moment kur kushdo është i lirë të ndjekë atë që beson. Jetojmë në një moment kur vetëm në 3 vjet, na ka vizituar një Papë, kemi shenjtëruar një nënë shqiptare, 38 martirë shqiptarë i janë shtuar Kishës së Shenjtë, e vetëm për të dytën herë në histori, kemi një Kardinal shqiptar. Janë shumë ngjarje në 3 vjet, për të mos u frymëzuar prej tyre. Sigurisht, jetojmë edhe një kohe idhujsh të rremë, por këta as kanë lindur sot e as do zhidhen nesër. E sigurisht Sinodi nuk do jetë një gjë e lehtë, por nëse kur të mbyllet, do ketë kthyer edhe një person të

vetëm në rrugën e duhur, për mua do ketë vlejtur. Nëse kthen dhjetë, njëqind, njëmijë, njëqindmijë, akoma më mirë.

E në kuadër të këtij Sinodi që nisim të përgatisim sot, e ndërkohe që presim të kuptojmë më shumë rreth tij, e detyrave që mund të na caktojnë ne, për të cilat personalisht shpreh që sot gadishmerine time për të bërë ç'të nevojitet e ç'të mundem, ne besimtarët mund të nisim menjëherë nga gjerat e vogla. Le të fillojmë duke i thënë dikujt si unë i para dy vjetëve, që dera e Kishës është e hapur për të gjithë. Që aty nuk bëhen vetëm disa rite të caktuara dekada a shekuj më parë, por që aty takohesh me Zotin, personalisht. Le të japim një buzëqeshje, e të themi se nga Kush buron ajo. E atyre që i shohim në Kishë rishtazi, t'u afrohem, t'i ftojme të ndajmë së bashku eksperiencën e fesë, e mbase do e kenë më të lehtë të mos largohen më prej aty. Po ashtu, të mos rreshtim asnjëherë së treguari kush jemi e pse jemi. Duket ndonjëherë, sikur jemi katolikë në Kishë e në shtëpi, por kur jemi jashtë, shndërrohemi në ateistë mondanë të prekur nga sëmundja e madhe e kësaj kohe, ajo e të qenurit politikisht korrekt, që fshehim besimin tonë nga droja se mos ofendojmë ata që nuk besojnë si ne.

Vëllezër e motra, nëse kur hyra në Kishë isha krejt i paditur, nuk pretendoj se për dy vjet kam bërë kush e di se çfarë hapa përpara. Ama, një gjë e kam kuptuar mirë, e ajo është forca e lutjes. Kam provuar në vetë të parë, se çfarë mund të arrihet duke u lutur e duke i'a lënë në dorë Zotit zgjidhjen. Ndaj, pavarësisht vështirësive që mendojmë se mund të ketë kjo ecje që nisim sot, me bindjen se për Zotin s'ka asgjë të pamundur, le t'i lutemi Shpirtit Shenjt që të na drejtojë në këtë ecje, e Zojës së Bekuar që të na mbrojë e të na ndihmojë. Qoftë Lëvduar Jezu Krishti!

Mbi mondanitetin shpirtëror dhe lutjen

Meditim për Rregulltarë e Meshtarë për Dioqezat e Tiranë – Durrës dhe Rrëshen

E hënë 23 tetor 2017. Katedrale e Shën Palit Tiranë

Nga Dom Arjan DODAJ

Përshëndetje të gjithëve,

1) Pjesa e parë: Mondaniteti shpirtëror

Ju falënderoj për prezencën tuaj, është e bukur të gjendemi mes nesh, priftërinj, rregulltarë e rregulltare, sepse kjo eksperiencë është eksperiencia e atyre që mbi të gjitha çojnë përpara Kishën, aspostullimin në Kishë, dhe ky apostullim është i përbërë pikërisht përmes kësaj dëshmie, që kërkohet të jepet mbi të gjitha kundër çdo lloj forme të mondanitetit.

Në fakt, Papa Françesku në "Evangelii Gaudium" në numrin 93, thotë : *jo ndaj mondanitetit shpirtëror, që fshihet pas dukjes së besimit dhe madje edhe dashurisë për Kishën e konsiston në të mos kërkuarit të laudisë së Zotit por Laudisë njerëzore dhe, mirëqënies personale, pikërisht kjo është ajo që Jezusi kritikon tek farizejtë. "Si të besohet në ju që kërkoni laudinë njëri me tjetrin?!"*

Për të fituar mbi këtë mondanitet shpirtëror kemi nevojë mbi të gjitha për tu ndërgjegjësuar mbi identitetin tonë, në fakt mondaniteti shpirtëror nuk është gjë tjetër përveç veshjes së identitetit që kemi nga Zoti, me ato çka mund të jenë gjykimet e botës mbi priftin, ose dhe gjykimi që vetë ne krijojmë mbi detyrën tonë.

Gjykimi i botës mbi priftin, para së gjithash

i botës që na rrethon, i kushtëzuar edhe nga brishtësia, dobësia e kontekstit të varfër të popullit të Zotit në Shqipëri, ose edhe gjykimi që ndoshta projekton mbi Priftin një ndjesi pushteti që duket si eksperiencë çliruese. Në fakt edhe dishepujt kishin shpesh herë një pritshmëri për një Jezus çlirues, që do të thotë një Jezus politik që do të kishte mundur në një farë mënyrë të bënte të heshtnin kontrastet dhe konfliktet, ose skllavërinë ndaj varësisë romake. Është kjo që ndoshta shpesh herë ndez mes njerëzve kundrejt nesh këtë urim ...që "Zoti të rritë pushtetin!"

Por ne e dimë shumë mirë që këto fjalë nuk korrespondojnë me planin e Zotit në jetën tonë, sepse Zoti ju zbulohet të përvuajturve, të varfërve, të thjeshtëve, është pikërisht në këtë që Jezuesi thotë: " të falenderoj o Atë, sepse i ke fshehur këto gjëra nga të pushtetshmit, të urtët e të dijsmit dhe ja u ke zbuluar të vegjëlve e të përvuajturve".

Shembullin primar në këtë e kemi në Zojën e Bekuar!

Dhe është ky momenti ku për ne shfaqet nevoja për një shqyrtim mbi vetë identitetin tonë, një identiteti që mbi të gjitha i përket përkushtimit tonë në raport me Krishtin, si rregulltarë, rregulltare e dioqezanë, jemi të gjithë të Krishtit, e kështu identifikohemi në këtë raport të thellë e të gjallë bashkimi me Të, dhe është Ai që na liron nga çdo formë e tundimit të mondanitetit.

Kjo eksperiencë çlirimi dhe hiri, nis sidomos për ne në një kontekst "Ecclesia", do me thënë të një asambleje, pra ndërsa jetojmë së bashku ecjen e Zotit. Për këtë, tundimi i parë që mund të hasim, është pikërisht ajo e të jetuarit si vetmitar, do me thënë single.

Rikujtojmë që etërit e Kishës thoshin " i shkreti ai që është "vetëm", sepse do të përfundojë keq". Ja ky tundim qoftë edhe në kontekstin e sotëm, shpesh edhe për shkak të nevojave të ndryshme për të shërbyer vetëm, ku do është, rrezikon që në një farë mënyrë të na largojë ose të na çrënjosë nga ndjenja jonë e përkatësisë me Ipeshkvin, me dioqezën, me kongregatën, ose me komunitetin në të cilin jemi të thirrur të jetojmë shërbimin tonë baritor, misionin tonë, sepse ka gjithnjë nevojë për këtë dimension sinoditeti me Ipeshkvin dhe mes meshtarëve. Ky trup i Kishës ka një forcë speciale, dhe ky trup duhet të ecë përpara gjithnjë me transparencën e angazhimeve me transparencën e virtyteve, pra me transparencën për të cilën flet Pali që është: kurajoja të flasësh, të thuash gjithçka, por kur je "vetëm – single", je akoma më shumë i kushtëzuar, nga dobësitë, nga kufizimet personale, e kështu na mungon me eksperiencën e të ecurit përpara kurajoja e të folurit. - Parrezia!

Kurajo për të folur duhet të na ndezi gjithnjë, të flasim gjithnjë, ama për Jezu Krishtin!! Në kohën tonë dëgjojmë shumë fjalë, dëgjohej të flitet gjithandej,



dëgjohej të flitet nga të gjithë e shpesh herë edhe në kremtimet tona dëgjohej të flitet nga personi në person, nga situata në situatë e për këtë humbet më pas dëgjimi i fjalës së Krishtit. Së fundmi kam marrë pjesë në një celebrim në të cilin folën të gjithë e ndoshta i vetmi që rrezikonte të mos fliste ishte Krishti...

Ndërkohë që jemi të thirrur të flasim pak, të flasim për Krishtin, në të kundërt do të mungojmë në këtë *Parrezi*, e për këtë do të rrezikojmë të strehohemi në frikën e të folurit haptas, e të reduktohem në një kontekst të vogël personash që ndoshta në një farë mënyre janë të vetëkënaqur e me një mentalitetit shpesh mondan, ndaj përfundojmë duke folur për këtë, për atë, për Ipeshkvin, për meshtarë ose për bashkëvëllain, por nuk kemi lirinë dhe Parrezin ... për tu përballur me çdo situatë e të flasim me zemër në dorë.

Ja pra, që eksperiencia e fjalës, pra Parresia është fryt i një eksperiencia purifikimi, të një pune mbi vetveten, ose do të guxoja të thoja me Ungjillin e Mateut 11. 12-15 ku Jezusi thotë "mbretëria e Hyjit i përket të dhunshmeve, dhe ata do ta përvetësojnë, pra dhuna e parë është pikërisht ajo që ushtrojmë mbi vetveten, dhunë që tregon mbi të gjitha një dominim ndaj vetë vetes për një

ushtrim durimi, ushtrim purifikimi dhe për një shqyrtësi mbi çdo formë fjale që nuk buron në jetën tonë nga Shpirti që takojmë me Krishtin në Eukaristi, (që është një eksperiencë më eksplozive se sa të prekim në korrent), në takim me Krishtin në mishin e vëllait, në Krishtin e mishëruar.

I foluri ynë, pra është fryt i të folurit me Mësuesin në Shkollën e tij, kjo do të na mundësojë të mësojmë edhe ne të qenin barinj, që siç do të thoshte Papa Françesku, që kanë erën e deleve, që në takimin me delet, takimin me popullin e Zotit, do të dijme të jemi më të afërt plagëve të tyre, të bëhemi më të aftë për tu afruar me nevojat e tyre e mbi të gjitha të fortë për të fituar atë klerikalizëm që në një farë mënyre na izolon nga realiteti dhe na bën të jetojmë në një botë paralele ndaj asaj të nevojës dhe dhurimit të vetvetes, për të cilin kanë nevojë vëllezërit tanë.

Ja pra nevoja jonë për të fituar mbi çdo formë të funksionarizmi, që do të thotë të reduktuarit në nëpunës funksionarë të misterit të Zotit, pra e të qenit ata që në një farë mënyre administrojnë gjërat e Tij, por që nuk dinë të bashkëndajnë përmes ekzistencës së tyre, shpirtit të tyre, ndjenjës së tyre, me jetën e vëllait. Në fakt Shën Pali na thotë "kini në ju

të njëjtën ndjenja të Jezu Krishtit, i cili edhe pse me natyrë Hyjnore nuk e konsideroi një thesar xhelez ngjashmërinë e tij me Atin, por e përuli vetveten dhe u zhvesh", dhe me eksperiencën e meshtarit duhet të zhveshim atë lavdinë njerëzore mondane që shumë herë mund ta hasim në takim me njerëzit.

Njerëzit sigurisht, për nga thjeshtësia, mirësia dhe besimi i tyre, shohin në priftin Krishtin që ecën në mesin e popullit të Tij, por prifti i vetëdijshëm për mjerimin e tij, për dobësinë e tij, kurrë nuk tërhiqet nga eksperiencia e bashkësisë dhe e purifikimit.

Edhe unë, për eksperiencë personale që prej Shugurimit Meshtarak në 2003 kam patur gjithnjë këtë hir për të mundur të bashkëndarë me popullin e Zotit çdo ditë këtë eksperiencë të takimit me nevojat e tij, me shpresat e tij, me vështirësitë e tija, me gëzimet e tij e me dhimbjet e tij. Shpesh kuptoj që është prezent gjithmonë ky tundim për të qënë në një farë mënyre të izoluarit e një përditshmërie administrative të gjërave të Kishës, ndërkohë që jemi të thirrur jo për ti administruar ato, por mbi të gjitha të dëshmojmë Ungjillin e të çojmë Krishtin e mishëruar tek njerëzit e për këtë na duhet fillimisht gjithnjë të takojmë vëllezërit, të shkojmë drejt njëri-tjetrit, të kërkojmë të jemi më të angazhuar në mundësitë baritore që kemi, por pa takimin me popullin, humbim eksperiencën e realitetit, të nevojës së vërtetë të shpirtit!

Në të kundërt, meshtari që është shumë klerikal është si ai farizeu që ka një teologji të vetën, që si në kohën e Jezusit, gjykon gjithçka duke u nisur nga vetja e tij, ku vendos vetë se çfarë duhet të bëjë, se çfarë duhet të bëjë Jezusi me njerëzit, se çfarë duhet të bëjë Jezusi me Kishën, se çfarë duhet të bëjë Jezusi me teologjinë dhe kështu rri i mbyllur në vetvete, larg nga e vërteta, nga nevoja e popullit, ndaj i pamundur të bashkëveprojë me realitetin e tyre.

-Vijon në numrin e ardhshëm

“Në Kalvarin e Ditëve Moderne” Takim me Klerin Dioqezan

Nga Dr. Majlinda GJONI

Falenderoj Mons. Gjergjin i cili me ka ftuar për të qënë ketu sot me ju.

Lëvizja për Jetën "Ndhimëtare e Foshnjave të Çmuara të Zotit" Disa prej jush mund të jeni në dijeni të misionit dhe të aktiviteteve që bëjmë por shkurtimisht do të përmend. Çdo të shtunë në orën 7:30 Don Henry kremton Meshën për Jetën në Kapelën e Shën Luçisë, pas meshe shkojmë një grup i vogël dhe lutemi tek spitali ku vriten fëmijët e pafajshëm. Kisha gjithmonë i shoqëron të vdekurit me lutje, jo vetem ato, por edhe ato që i lënë pas. Lutja është e vetmja përgjigje!

Çdo të shtunë të parë të muajit perveç Meshës kemi edhe Adhurim të Shejtnueshmë Sakrament. Një pjesë e grupit qëndron në Adhurim dhe një pjesë shkon në procesion duke lutur Rruzaren, Misteret e Gezimit dhe të Dritës duke shkuar, Misteret e Mundimit përpara spitalit dhe Misteret e Lumturisë dhe Mëshirës Hyjnore në kthim.

Kjo zgjat nga ora 7:30-10:00. Cdo dite nga ora 8:30-9:30 shkojmë tek spitali dhe lutemi, këshillojmë dhe shpërndajmë flet palosje ku demonstroi zhvillimit e fëmijës në barkun e nanës dhe pastaj se çfarë i ndodh pas abortit fëmijës. Prezenca jonë është e shoqërua nga postera, fytyra e Krishtit, Zoja e Guadalupe pajtoria e të palindurve, lutuni që ti jepet



fund abortit, dhe fytyrën e abortit, fëmijën e abortuar.

Si rezultat i kësaj pune shumë fëmijë gëzojnë jetën dhe moshën e fëmijëve të parë është tashme 6 vjeç çka demonstroi se frytet e dukshme të këtij misioni janë fëmijët e gjallë dhe shpëtimi i nënave nga plaga e rëndë që len aborti në zemrat e tyre, familjet e tyre dhe tashme në krejt shoqërinë mbarë botërore. Ju e dini më mire se sa unë, me anë të rrefimit se sa shume aborti e ban me vujt një nanë e cila deri në momentin e vdekjes nuk e harron fëmijën të cilin e ka abortuar.

Pse jemi atje çdo ditë?

Pse luteni tek spitali dhe jo në kishë apo në shtëpi?

Kjo është pyeja që shpesh herë na bëhet dhe gjykohej për prezencën tonë tek shkallët e spitalit. Na thonë kjo nuk është mënyra e duhur për tu luftuar aborti!!

Asyeja se pse ne shkojmë atje është sepse aty kryqëzohet çdo ditë Krishti në fëmijët e pafajshëm. Krishti nuk u kryqëzua në Kishë, as në shtëpi por në shesh publik në Golgotë. Ndërsa fëmijët e pafajshëm kryqëzohen në Golgotën e ditëve moderne që është jo shumë larg shtëpisë së gjithësecilit prej nesh.

Prandaj edhe ne dalim në rrugë me e shoqëru Krishtin aty ku ai Kryqëzohet në fëmijët e pafajshëm, ku nënat shkatërrohen dhe një agoni fillon dhe nqs nuk gjendet dikush për ti ndihmu kjo

agoni nuk ka të mbarur. Shpesh mendojnë se ne jemi protestues por ne nuk protestojmë, thjeshtë lutemi. Ne nuk i shoqërojmë me ulërima dhe gjykime por mundohemi ti përngajmë Zojës së Bekuar dhe Shën Gjonit kur ato ishin tek këmbët e Kryqit. Ato e kanë shoqëru Krishtin në Lutje dhe nuk i kanë dënuar ato që e kryqëzuan. Krishti kishte 12 apostuj por vetëm njëri e shoqëroi te këmbët e Kryqit. Së bashku me Nanën dhe disa gra.

Në vigjiljen e fundit ditën e shtunë 14 Tetor me dom Martin Thompson, i cili udhëhoqi Vigjiljen për Jetën të cilin e falënderoj shumë, kemi qenë rreth 15-20 veta, në Tiranën që është një milion banorë!

Qëllimi jonë primar nuk është për të shpëtuar bebe, por për të shpëtuar shpirtin. Fëmija është i prekur fizikisht nga aborti por shpirti i fëmijës shkon në duart e Zotit. Por shpirtin e nënave, mjekëve dhe të gjithë atyre që janë të përfshirë në abort janë në rrezik për bjerrje të përhershme nëse se nuk konvertohen. Dhe këto gjëra ju i dini më mirë se sa unë. Arsyeja se pse jam këtu është e thjeshtë: E di që të gjithë keni angazhimet tuaja me punë dhe aktivitete të ndryshme por ky mision ka nevojë për suportin tuaj.

Në Shqipëri, që nga 1994 që është miratuar ligji i abortit deri në 2016 nga statistikat e Instat gjendja ka shkuar deri në 306 324 fëmijë të abortuar! Kjo është vetëm maja e ajsbergut pasi në këtë statistikë nuk janë të përfshira klinikat dhe spitalet private. As ato që janë deklaruar në spitalet shtetërore nuk janë të vërteta pasi abortet shënohen si aborte spontane që të gjithë lekët të shkojnë në duart e mjekëve.

Këtu në këtë statistikë nuk përmenden pilulat dhe mjetet kontrceptive të cilat janë e njejta gjë por thjeshtë ndryshon procedura e kryerjes së abortit. Nënata që kanë kryer abort një herë mundësia për ta përsëritur abortin është 50 %. Prandaj numri i aborteve nuk është ma 300 mijë e ca por vetëm një Zot e din se sa është numri real i fëmijëve të vrarë!

Përveç pasojave shpirtërore që ju i prekni cdo ditë në punën tuaj. Do të ju informoj shkurtimisht mbi pasojat fizike dhe psikologjike. Nënata që kryejnë abort, bien në ulje e vlerësimit për veten, ndërpresin marrëdhënien me fëmijët e tjerë, me burrin, që çon deri në divorc, depresion, ankth, droge, alkool, deri në vetëvrasje etj. Pasojat fizike hemoragji, infeksion, mos pasje me të fëmijëve, tromboemboli, kancer të gjoksit, të mitrës, etj.

Në vendet e tjera si USA fëmijët abortohen deri në muajin e 9, nqs fëmija lind gjallë ato lihen të vdesin në errësirë në koshin e mbeturinave, në të shumtë e rasteve mbyten nga stafi mjekësor. Organet e fëmijëve shiten pjesë, pjesë si vegla makine. Në Australi fetuset përdoren si bizhuteri nga nënat e tyre! Fëmijët mbas abortit i duan të gjallë që të bëjnë eksperiment me ta. E shumë e shumë makabritete të tjera që vetëm një mendje djallzore mund të bëjë të tilla gjëra!!

Fëmija gjatë procesit të abortit ndjen dhimbje pasi sistemi nervorë i fëmijës fillon dhe formohet që në javën e katërt, dhe reagon ndaj dhimbje 8 javësh. Imagjino se çfarë tmerri është që të shqyhen organet ndërsa ti ndjen dhimbje. Dhimbja me e madhe e nënave është kur ato kanë abortuar një fëmijë që ka pasur për tu bërë një meshtarë apo motër. Pastaj ankohe mi që s'kemi thirrje! S'kemi se si me pas thirrje pasi shumë prej tyre janë abortuar.

Shoqëria njerëzore ka rënë, jo ne nivelin e kafshës, pasi të gjithë e dimë se kafshët i mbrojnë fëmijët e tyre, por ka rënë në nivelin e egërsirës që është qoftëlargu. Aborti është vetëm vepër e djallit dhe shpikje e tija. Kjo është periudha më makabre e njerëzimit. Asnjë luftë e të gjitha kohrave nuk ka vrarë më shumë se viktimat e abortit!

Në Shqipëri një nanë lind 1.6 fëmijë që do të thotë një fëmijë e gjysëm jemi nën nivelin e zëvendësimit të popullatës. Shoqëria Shqiptare po vdes, aborti, kontracepsioni, sëmundjet kancerogjene ose jo, aksidentet rrugore, gjakmarrja, emigracioni etj po çojnë drejt zhdukjes shqiptarët. Kemi nevojë për suportin tuaj që shqiptarët dhe ky mision të vazhdojë dhe të përhapet më gjërë.

Suporti që ne kërkojmë është që të paktën një orë në javë, muaj tja kushtoni Zotit për këtë qëllim. Me një orë tek spitali, pasi veshja dhe prezencia juaj bën diferencën, impakti është më i madh. Një rruzare ose një orë Adhurim nqs nuk keni mundësi të na shoqëroni tek spitali. Nëse dikush nga ju ka dëshirë mund të vij te flas 10 min mbas Meshe në famullitë tuaja ose në takimet që ju mund të organizoni. Nga eksperiencia ime personale mbi 95% e nënave kanë kryer abort jo vetëm një herë por e kanë përsëritur disa herë. Raste janë më nga ekstremet në Shqipëri 21, 41, në Amerike 70 aborte një nanë!! Zoti pastë mëshirë për ne!

Nënata shpesh herë nuk e dinë se aborti, kontracepsioni janë mëkate mortare të vdekshme, jo vetëm që nuk e rrefejnë por edhe marrin Kungimin e Shejtë, Krishtin, sikur nuk ka ndodhur asnjë. Kemi nevojë të dëgjojmë më shpesh mësimin e Kishës nga amboni mbi abortin dhe kontracepsionin. Sepse pak dhe aspak përmenden këto gjëra.

Një gjë tjetër dua të shtoj Qendra për Jetën "Nanë Tereza" është e hapur, bën ekografi falas, test shtatzanie dhe këshillim falas për nënat që mendojnë të abortojnë. Mund ti ndihmojmë çiftet e reja edhe me metodat natyrore të planifikimit të familjes. Bëjeni njoftimin e këtij vendi në të cilën kjo lloj kategorie mund të gjejë suport falas. Vendi dhe suportin janë por njerëzit nuk e dinë!

Për ta mbyllur dhe për tu treguar rëndësinë se pse duhet të jemi tek këmbët e Kryqit të Krishtit, aty ku fëmijët vriten. Do të ju tregoj se çfarë me ndodhi: ditën e Premte vijnë dy zonja ju jap fletëpalosjen, dhe menjëherë ndalen. Po diskutonin me njëra tjetrën, ju afrohem se më shkoi mendja që janë për abort. Ju them a keni nevojë për ndonjë ndihmë? Me se mund të ju ndihmoj? Ajo që ishte për abort mu përgjigj. Pse tani erdhi kjo? Dhe ka shpërthyer në lot. Unë ka dy javë që po bëhem gati për ta abortuar dhe sot që kisha vendosur për ta abortuar erdhi kjo. Kam marrë lek borxh dy herë njëherë herë i kam harxhuar dhe kam marrë dhe 100 euro borxh nga motra dhe kam ardhur sot. I kam thënë ti nuk mundesh me marrë lek borxh me vra fëmijën tënd. Ka dy javë që vij këtu përditë për të bërë abortin, une nuk ju kam parë këtu. Ju nuk keni qenë! Unë i thashë kemi qenë çdo ditë por vijmë herët sepse më duhet të shkoj në punë.

I kam thënë fëmija jot është jetë gjatë, është dhuratë prej Zotit, mos e shkatërro atë, ne jemi këtu

sepse Zoti të don ty dhe fëmijën tënd. Kjo është arsyeja se pse pikërisht jemi taku sot. Nëse ke nevojë për ndihmë do të mundohemi me të suportu, me ushqime, rroba. Nqs nuk ke mundësi, fëmijën ta rrisin motrat e Nanë Terezës kur të bëhesh më mire ekonomisht shkon dhe merr fëmijën, ose nqs nuk e don fëmijën mund ta lesh në adoptim.

Me tha që jam në gjendje të vështirë ekonomike, pa shtëpi një fëmijë të sëmur me diabet, dhe një 11 muajsh. I thashë që do të ndihmojmë. Fëmija i saj ishte 10 javësh, i demonstroj përmasat e fëmijës që kishte në bark, i demonstroj se si fëmija do bëhet pasi ajo të ketë lënë doktorët të ja abortojnë. I kam dhënë fletëpalosje dhe i kam thënë nqs ke nevojë për mu më kontakto në çdo moment. Më tha do të mendohem dhe një herë dhe nuk është futur në spital, por ka iku dhe vetëm Zoti e din nëse ajo është kthyer prap apo jo, pasi mu desh të shkoja në punë. Jemi lutur për nënë që Zoti të mbrojë nga mashtimi i djallit dhe për fëmijë që Zoti ti shpëtojë jetën.

Tek spitali takojmë dy lloj kategori nënash, siç Krishti në Kryq është kryqëzu së bashku me dy lloj cubash! Njëri u pendua përpara dhe i tha Krishtit ki mëshirë për mua kur të shkosh në mbretërinë tënde. Ka nëna që pendohen, kthehen dhe nuk e bëjnë abortin kur shohin persona që luten tek dera e spitali. Lutja i bën të mendojë për Zotin dhe se fëmija vjen prej Tij. Por kemi edhe një kategori tjetër nënash të cilat pendohen pasi e kanë kryer abortin. Kur shohin prezencën tonë duke u lutur mendojnë se çfare kanë bërë, kam vrarë fëmijën e Zotit. Kjo tregon se sa e rëndësishme është prezencia jonë aty, jemi për nënat para dhe pas abortit.

Nga eksperiencia e Mons. Philip Reilly i cili për 50 vite ka shpëtuar mbi rreth 100 000 fëmijë dhe ka këshilluar nënat në rrugë thotë: sa herë e kam dëgjuar shprehjen: sikur vetëm një person të kishte qenë tek dera e abortit unë KURRË nuk do të kisha kryer abort. Prandaj është shumë e rëndësishme dalja në rrugë dhe shoqërimi i nënave dhe fëmijëve me lutje. Çdo njeri nuk dëshiron të vdesë vetëm, as Krishti nuk ka dëshiruar që të vdesë vetëm, por ju ka thënë Apostujve rrii zgjuar e Lutuni. Lutjet dhe prezencia jonë është e vetmja dashni që këto fëmijë marrin gjatë jetës së shkurtër në tokë.

Metodat e suportit janë:

1. Një orë lutje tek spitali Koço Gliozheni 8:30-9:30
2. Një orë Adhurim i të Shejtnueshmit Sakramen për këtë qëllim.
3. Një rruzare kushtuar Zojës së Bekuar
4. Sikur një Ati Ynë të lutni me devocion për këtë qëllim shpëton një fëmijë nga abort.

Kush është i interesuar për të na suportuar është i mire se ardhur.

Faleminderit.



Kushtimi i kishës së Shën Alfonsit në Kamëz

Nga P. Laureano Del OTERO CSSR

Më 14 tetor 2017, Imzot Gjergj Frendo MOP, arqipeshkëv i Tiranë-Durrësit, ka kremtuar kushtimin solemn të Kishës Famullitare të Shën Alfonsit në Kamëz.

PSE SHUGUROHEN KISHAT?

Kisha në të vërtetë është Populli i Hyjit, Familja e Zotit, Bashkësia e besimtarëve, d.m.th. Kisha jemi të gjithë besimtarë që jetojmë Ungjillin e Krishtit në tokë, në këtë kohë dhe në të gjitha kohërat.

Por nga fillimi i historisë së Kishës, bashkësia e të krishterëve i ka kushtuar Zotit ndërtesa të vëçanta ku kremtoheshin Sakramentet e Shenjta dhe kremtimet e tjera. Ato ndërtesa kanë marrë emrin "Kishë" dhe normalisht, sipas traditës së Kishës, janë të kushtuar nëpërmjet një riti perkatës që quhet "kushtim ose përkushtim" nga ipeshkëvi si Bariu i Kishës Dioqezane.

Si ka thënë Kardinali Ernest TROSHANI në kushtimin e Katedrales së Prishtinës (05.09.2017): *"Krishti është i pranishëm në Eukaristi në çdo Kishë, ky Krishti me korp e me shpirt, i etshëm për njerëz, e posaçërisht mëkatarë, që të mund edhe ata ta shohin lumninë e Zotit. Krishti është Babë i gjithë njerëzimit."*

KISHA NË KAMËZ

Pas komunizmit, Dom Oreste VALLE SDB e ka blerë shpëtinë e kulturës dhe banesat për t'iu shërbyer bashkësisë katolike që në atë kohë kanë banuar në Kamëz. Pas disa punimeve, Kisha e Shën Palit (ashtu quajtur) filloi shërbimin baritor në Kamëz, që pastaj e ka vazhduar Dom Korrado VAN KERSCHAUER.

Me kalimin e kohës, Dom Gjergj META, sot ipeshkëvi i Mirditës, me ndihmën e shumë njerëzve të Famullisë dhe bahskëpunëtorëve të tjerë (edhe nga fe të ndryshme) e kanë zgjërëuar Kishën, sepse bashkësia katolike është rritur shumë kohët e fundit. Në atë kohë Famullia kishte emrin e Shën Gjonit Maria Vianej, prifti francez pajtori i famullitarëve. Sot, Famullia e Kamzës është një nga Famullitë më të mëdha në Shqipëri, dhe Kisha e saj nuk ka qënë kushtuar Zotit përpara. Famullitarët kanë kremtuar aty dhe Kisha ka qënë e bekuar, por jo e kushtuar Zotit.

Kushtimi i Kishës është një rit i vëçantë që kremtohet në Kishat e rëndësishme. Ka qënë dëshirë e Imzot Gjergj FRENDO OP në fillimin e shërbimit të tij si arqipeshkëv që të gjitha Kishat e dioqezës që akoma nuk janë të kushtuara Zotit të kushtohen. Kisha e parë e kushtuar Zotit nga Imzot Frendo është Kisha e Kamzës; një hir dhe një nder për këtë Famulli.

Gjithashtu, në atë ditë Kisha Katolikë e Kamzës ka marrë emrin e Shën ALFONSIT, Ipeshkëv dhe Mësues i Kishës, themeluesi i Kongregatës së Misionarëve Redentoristë dhe Pajtori i Rrëfyesëve dhe Moralistëve të mbarë Kishës. Nga 2014, Misionarë Redentoristë janë duke shërbyer në Famullitë e Kamzës dhe Bathores, po ashtu edhe në Fushë-Krujë.

RITI I KUSHTIMIT TË KISHËS SË SHËN ALFONSIT

Riti i kushtimit të Kishës së Shën Alfonsit në Kamëz filloi më 14 tetor, në orën 10:00, me procesionin e meshtarëve bashkëkremtues dhe ministrantëve, me arqipeshkëvi tonë Imzot Gjergj Frendo OP dhe famullitari Atë Laureano Del Otero Sevillano C.Ss.R.



drejt dyerve hyrëse të Kishës. Ishin të pranishëm shumë meshtarë, rregulltarë e rregulltare dhe laikë nga e gjithë dioqeza. Gjithashtu ishin të pranishëm Eproret Redentoristë nga Këshilli i Përgjithshëm i Kongregatës, koordinatori i Redentoristëve të Europës dhe Provinciale të Italisë dhe Spanjës. Në oborrin e Kishës qendronin shumë besimtarë dhe autoritete të qytetit të Kamzës së bashku me zotin Xhelal Mziu, kryetari i bashkisë.

Në hyrje, arqipeshkëvi i ka dhuruar çelsat e Kishës famullitare dhe ai ka hapur dyert e saj. Pastaj, brenda Kishës, arqipeshkëvi bekoj ujin dhe spërkati besimtarët, Kishën dhe muret e saja me ujin e bekuar. Kori i Famullisë së Kamzës këndoi gjatë ceremonisë, duke bërë kremtimin akoma më bukur.

Në momentin e Liturgjisë së Fjalës, tre lexues, njëri prej të cilëve mban Librin e Leximeve, u paraqiten para Ipeshkëvit. Ipeshkëvi mori Librin e Leximeve, ia tregoi popullit duke thënë: *Tingëlloftë gjithmonë në këtë vënd Fjala e Hyjit; zbuloftë dhe shpalltë Misterin e Krishtit dhe veproftë në Kishë shëlbimin tone.* Atëherë, arqipeshkëvi dorëzoi Librin e Leximeve lexuesit të parë dhe lexuesit shkuan tek Amboni. Të gjithë u ulen dhe dëgjuan Fjalën e Zotit si çdo të dielë. Gjatë predikimit, Imzot Frendo ka folur për ritin e kushtimit dhe për Shën Alfonsin si një model i përshtatshëm për besimtarët e sotëm sepse ia kishte kushtuar jetën e vet ungjillizimit të popullit, me një stil varfërie dhe me shumë dashuri për Shenjten Mari, Nënë e Hyjit.

Pas predikimit, fillon ritin e kushtimit me litanitë e shenjtëve dhe vendosjen e dy relikëve nën altar. Reliket janë nga trupi i Shën Alfonsit, themeluesi i Redentoristëve dhe pajtori i ri i Famullisë së Kamzës, dhe Shenjtja Filippa Mareri, themeluesja e Motrave Françeskane që kanë filluar shërbimin e tyre në Famullinë e Kamzës në muaj shtator.

Arqipeshkëvi shuguroi altarin duke e lyer me Bagmin e Shenjtë ose Krizma. Gjithashtu me këtë Vaj të Shenjtë (Krizma) arqipeshkëvi, vikari i përgjithshëm dhe famullitari lyën edhe dymbëdhjetë kryqet në shtyllat e Kishës, që simbolizojnë të dymbëdhjetë Apostujt e Krishtit. Mbi altar u dogj kemi, që u shoqërua me këngë dhe lutjen e kushtimit nga ana e arqipeshkëvit. Atë Laureano dhe Atë Andrzej, të dy Misionarët Redentoristë të bashkësisë së Kamzës, këmbosën popullin dhe pastaj, vazhdoj veshja e altarit dhe ndriçimi i Kishës (ndezja e qirinjëve që janë poshtë 12 kryqeve), duke përgatitur vendin për kremtimin eukaristik.

Pas kungimit të besimtarëve, arqipeshkëvi vendosi Korpin e Krishtit në tabernakull në mënyrë solemne, dhe adhuroi Zotin së bashku me popullin. Një Epror i Lartë nga Kongragata e Misionarëve Redentoristë, Vella Jeffrey Rolle C.Ss.R., e falenderoj Zotin për këtë ngjarje të rëndësishme dhe arqipeshkëvin për kremtimin dhe besimin dhënë Kongregatës së tij për të ungjillizuar besimtarët e Kamzës. Mesha e Shenjtë mbaroi me bekimin e fundit nga arqipeshkëvi dhe një festë në oborrin e Kishës, drejtuar nga animatorët e Famullisë.

